

VENDIM
Nr. 114, datë 13.2.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË
MAMURRAS TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisje vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Mamurras të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Mamurras të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr. 67, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Mamurras të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Mamurras për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha